



Tel: +355 4 22 69097
+355 4 22 69325
Fax
E-Mail: info@dpa.gov.al

Kontratë me pronarin e skemës

Kodi DA-FO-092

Rishikim nr 0
Dt 14.11.2024

Faqe 1 nga 6

I. SUBJEKTET

Sot më datë _____, është lidhur kjo kontratë, midis palëve të mëposhtme (këtu e në vijim referuar si “Kontrata”):

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E AKREDITIMIT themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me numër unik identifikimi (NUIS) **K51724027V**, me seli në adresën “Rruga e Durrësit”, Nr.27, Kati:III-të,Tel:+355 4 2269097; e-mail: info@dpa.gov.al, Tiranë, e përfaqësuar në këtë Kontratë nga Drejtor i Përgjithshëm Znj. Pranvera Fagu (këtu e në vijim referuar si “**DPA**”)

dhe

PRONARI I SKEMËS _____

themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar me numër unik identifikimi (NUIS) _____, me zyrë qendrore në adresën Rr.“.....përfaqësuar nga Znj/Z. _____, në cilësinë e _____, (këtu e me poshtë referuar si “**PS**”)

i cili ka aplikuar për: (Këtu plotësohet skema e vlerësimit të konformitetit)

DPA dhe PS referohen këtu e në vijim bashkërisht si “Palët”, ose veçmas si “Pala”

Baza Ligjore: Ligji Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 667, datë 29.7.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit”, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 737, datë 09.09.2015 “Për përcaktimin e tarifave të Akreditimit dhe për trajnimet e organizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit” i ndryshuar, si dhe legjislacionin në fuqi që rregullon përkatësisht marrëdhëniet në Republikën e Shqipërisë.

II OBJEKTI I KONTRATËS

Kjo kontratë rregullon marrëdhëniet juridike / financiare dhe bashkëpunimin ndërmjet DPA-së dhe PS-se në lidhje me skemën e vlerësimit të konformitetit.

Qëllimi i kësaj kontrate është shqyrtimi dhe pranimi nga DPA i skemës së vlerësimit të konformitetit të emërtuar _____, të paraqitur nga PS nëpërmjet formularit të aplikimit DA-FO-079 dhe listës kontrolluese DA-FO-080 në përputhje me procedurën DA-PM-008 “Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve”.



Tel: +355 4 22 69097
+355 4 22 69325
Fax
E-Mail: info@dpa.gov.al

Kontratë me pronarin e skemës

Kodi DA-FO-092

Rishikim nr 0
Dt 14.11.2024

Faqe 2 nga 6

III. KOHËZGJATJA

2.1 Kjo kontratë hyn në fuqi më me nëshkrimin e saj.

2.2 Kontrata mund të zgjidhet nga secila nga Palët, pas një njoftimi paraprak me shkrim, 15 (pesëdhjetë) ditë përpara datës së parashikuar për zgjidhje ose për një nga arsyet e përcaktuara në Kreun VI.

IV. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

5.1. Të drejtat dhe detyrimet e DPA

- 5.1.1 DPA është organizmi i vetëm kombëtar akreditues për skemat e reja të akreditimit në bazë të Ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
- 5.1.2 Pranimi i skemave të vlerësimit të konformitetit është vullnetar dhe i hapur për çdo PS, i cili plotëson kërkesat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi dhe procedura DA-PM-008 “Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve” e miratuar nga DPA.
- 5.1.3 Pranimi i një skeme të vlerësimit të konformitetit përbën vlerësimin nga DPA nëse një skemë i përmban të gjithë elementët për tu konsideruar skemë vlerësimi konformiteti por nuk përbën vërtetim të kompetencës, natyrës teknike apo një garanci në lidhje me shërbimet profesionale të ofruara nga PS.
- 5.1.4 Verifikimi i konformitetit të skemave të reja të vlerësimit të konformitetit me kërkesat e përcaktuara në legjislacioni në fuqi dhe kërkesat e DPA kryhet në mënyrën e përcaktuar në Procedura DA-PM-008 “Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve”, të publikuar në faqen zyrtare www.dpa.gov.al.
- 5.1.5 DPA pranon aplikimin për skemën e vlerësimit të konformitetit pas nënshkrimit të kësaj kontrate dhe PS duhet të depozitohet në aplikim formularin e aplikimit DA-FO-079 dhe listen kontrolluese DA-FO-080 si dhe dokumentacionin shoqërues në përputhje me procedurën DA-PM-008 “Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve”.
- 5.1.6 DPA, pasi ka verifikuar formularin e aplikimit DA-FO-079, listen kontrolluese DA-FO-080 dhe dokumentacionin e depozituar nga pronari i skemës, përputhshmerinë e skemës së vlerësimit të konformitetit të emërtuar _____, me kërkesat normative të zbatueshme dhe me procedurën DA-PM-008 “Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve”, si dhe legjislacioni në fuqi, autorizon PS të përdorë në dokumentacionin e saj formën e pranimit të dhënë nga DPA por pa përdorur logon e DPA. Logoja e DPA mund të përdoret vetëm nga organet e



Tel: +355 4 22 69097

+355 4 22 69325

Fax

E-Mail: info@dpa.gov.al

Kontratë me pronarin e skemës

Kodi DA-FO-092

Rishikim nr 0
Dt 14.11.2024

Faqe 3 nga 6

akredituara.

- 5.1.7 Me pranimin e skemes se vleresimit te konformitetit, DPA do të publikojë në faqen e saj të internetit www.dpa.gov.al informacionin në lidhje me fillimin e aktivitetit për skemën e re të vlerësimit të konformitetit të emërtuar _____.
- 5.1.8 Për çdo ndryshim që DPA mund të kryej në procedurën DA-PM-008 “Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve” gjatë kohës që një skemë e re është në shqyrtim, do të publikohen në faqen zyrtare www.dpa.gov.al si dhe duhet t’i njoftohen pronarit të skemës për përfshirjen e këtyre ndryshimeve në aktivitetet e saj, duke respektuar afatin kohor të përcaktuar në DA-PM-008.
- 5.1.9 DPA kryen vlerësime të përditësimeve ose ndryshimeve të kryera nga PS në skemën e vlerësimit të konformitetit të emërtuar _____, dhe vendos për pranimin ose jo të këtyre ndryshimeve. Vendimi i DPA duhet t’i komunikohet PS, i cili vendos për të vazhduar në përputhje me përcaktimet e DPA për skemën e vlerësimit të konformitetit ose zgjidh kontratën, në përputhje me parashikimet e kreut II dhe VI.
- 5.1.10 DPA e cila bën vlerësimin dhe pranimin e skemes nuk bëhet PS. Pronësia e skemës si dhe përgjegjësitë mbi dobinë e kërkesave teknike të skemës së vlerësimit të konformitetit, ligjshmërinë, efektivitetin, vlefshmërinë, përshtatshmërinë si dhe përfaqësimin e nevojave të palëve të interesuara lidhur me skemën i mbeten PS. DPA nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë dëm apo efekt negativ të produkteve nga skema e vlerësimit të konformitetit të miratuar prej saj.

5.2. Të drejtat dhe detyrimet e PS

- 5.2.1 PS ka të drejtë të aplikojë pranë DPA për skemën / at e vlerësimit të konformitetit në përputhje me procedurën DA-PM-008 “Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve”, pas nënshkrimit të kësaj kontrate duke depozituar formularin e aplikimit DA-FO-079, listen kontrolluese DA-FO-080, si dhe dokumentacionin shoqërues.
- 5.2.2 Pronësia e skemës, përgjegjësitë mbi dobinë e kërkesave teknike të skemës së vlerësimit të konformitetit, ligjshmërinë, efektivitetin, vlefshmërinë, përshtatshmërinë si dhe përfaqësimin e nevojave të palëve të interesuara lidhur me skemën janë pronë e PS.
- 5.2.3 Nëse DPA kryen ndryshime në procedurën DA-PM-008 “Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve” gjatë kohës që një skemë e re është në shqyrtim nga DPA, DPA duhet të informojë PS brenda 30 ditëve në lidhje me ndryshimet e bëra, edhe pse kjo procedurë është publikuar në faqen zyrtare www.dpa.gov.al. PS pas njoftimit të marrë mund të pranojë përfshirjen e këtyre ndryshimeve në aktivitetet e tij ose mund të mos pranojë përfshirjen e këtyre ndryshimeve duke zgjidhur kontratën, në përputhje me parashikimet e kreut V.



Tel: +355 4 22 69097
+355 4 22 69325
Fax
E-Mail: info@dpa.gov.al

Kontratë me pronarin e skemës

Kodi DA-FO-092

Rishikim nr 0
Dt 14.11.2024

Faqe 4 nga 6

- 5.2.4 PS do të njoftojë DPA-në brenda 30 ditëve për çdo përditësim ose modifikim të skemës së vlerësimit të konformitetit të emërtuar _____, në përputhje me procedurën DA-PM-008 “Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve”. DPA do të vendosë nëse është e mundur të ruhet vlefshmëria e skemës së vlerësimit të konformitetit ose nëse është e nevojshme të kryhet një vlerësim i detajuar, përpara se të konfirmohet vlefshmëria e skemës.
- 5.2.5 Çdo informacion në lidhje me skemën e vlerësimit të konformitetit të miratuar, objekt i kësaj kontrate, mund të përdoret nga pronari i skemës për çdo përdorues që kërkon kryerjen e aktiviteteve ose shërbimeve për skemën e vlerësimit të konformitetit të emërtuar _____, duke lejuar PS të ushtrojë të gjithë të drejtat për implementimin e skemës së miratuar nga përdoruesit.
- 5.2.6 PS do t’i vendosë DPA në dispozicion të gjithë dokumentacionin për shqyrtimin si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për të verifikuar deklaratimet e dhëna në aplikimin për praninë të skemës së re të vlerësimit të konformitetit (DA-FO-079 dhe DA-FO-080).
- 5.2.7 PS është përgjegjës për deklaratat e dhëna dhe DPA nuk mban përgjegjësi për deklarime të rreme të dhëna në formularin e aplikimit DA-FO-079 dhe listën kontrolluese DA-FO-080.
- 5.2.8 PS garanton DPA se nuk do të jetë objekt i asnjë pretendimi, kërkesë dhe/ose veprimi të ndërmarrë nga palë të treta në rast veprimesh apo mosveprime të kryera nga ai vetë me keqdashje apo mashtrim.
- 5.2.9 PS do të zbatojë procedurën DA-PM-008 “Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve” të DPA-së dhe nuk do të ndërmarrë asnjë aktivitet që mund të jetë i dëmshëm për DPA.
- 5.2.10 PS do t’i referohet skemës së vlerësimit të konformitetit vetëm në lidhje me fushën për të cilën i është miratuar pranuar skema.

V. INFORMACIONI DHE KONFIDENCIALITETI

Gjithë informacioni i marrë gjatë procesit të vlerësimit dhe miratimit të skemës së vlerësimit të konformitetit do të konsiderohet dhe mbetet konfidenciale dhe nuk do t’i zbulohet palëve të treta, Përgjashtimisht në rastet kur përcaktohet detyrimi për dhënien e informacionit sipas dispozitave urdhëruese dhe legjisllacionit në fuqi.

alet do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që të gjitha informacionet dhe/ose njohuritë teknike të shkëmbyera në lidhje me perfundimin ose permbushjen e kësaj kontrate, të fituara gjatë kryerjes së aktiviteteve që lidhen me këtë kontratë, të mbeten konfidenciale dhe nuk do të zbulohen paleve të treta.

VI ZGJIDHJA E KONTRATËS

Secila palë njofton menjëherë palën tjetër me shkrim për zgjidhjen e kësaj Kontrate nëse:



Tel: +355 4 22 69097
+355 4 22 69325
Fax
E-Mail: info@dpa.gov.al

Kontratë me pronarin e skemës

Kodi DA-FO-092

Rishikim nr 0
Dt 14.11.2024

Faqe 5 nga 6

- a) PS tërhiqet nga kjo kontrate në çdo kohe me anë të një njoftimi me shkrim 15 ditor dërguar DPA-së me postë ose me email.
- b) PS ndërpret apo kërcënon se do të ndërpresë procesin e vlerësimit të skemës pa shkak të arsyeshëm;
- c) Palët arrijnë një marrëveshje me shkrim mbi zgjidhjen e Kontratës;

VII. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

7.1 Kjo kontratë rregullohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

7.2 DPA dhe PS duhet të bëjnë çdo përpjekje për të zgjidhur mosmarrëveshje ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë kontratë me mirëkuptim.

7.3 Pas shterimit të të gjitha përpjekjeve për zgjidhjen paqësore të ndonjë mosmarrëveshjeje, kundërshtimi ose kërkese që rrjedh nga/ose në lidhje me këtë kontratë ose shkelje të kontratës, palët kanë të drejtë ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të kërkuar zgjidhjen e - me ndërgjyqësi.

VIII. KONKLUZIONE

8.1 Procedura DA-PM-008 “Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve” e publikuar nga DPA, si dhe ndryshimet dhe / ose shtesat, janë pjesë përbërëse e kësaj marrëveshje pas publikimit të tyre në faqen e internetit të DPA.

8.2 Të gjitha të dhënat dhe informacionet ndërmjet palëve do të bëhen me shkrim.

Adresat e palëve janë si më poshtë:

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E AKREDITIMIT:

Rruga “Durrësit”, Nr. 27, Tiranë

PRONARI I SKEMËS

Adresa:

Numër kontakti:

Kontrata do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe mund të ndryshohet vetëm me miratimin me shkrim nga të dy Palët.

Kjo Kontratë do të rregullohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Kjo Kontratë u hartua në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje 2 (dy) kopje për secilën Palë. Çdo kopje ka të njëjtën përmbajtje dhe të njëjtën vlerë ligjore.



Tel: +355 4 22 69097
+355 4 22 69325
Fax
E-Mail: info@dpa.gov.al

Kontratë me pronarin e skemës

Kodi DA-FO-092

Rishikim nr 0
Dt 14.11.2024

Faqe 6 nga 6

Palët:

Në interes të DPA:

Në interes të PS:

Znj. Pranvera FAGU

Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al	Kontrata me OVK	Kodi DA-FO-038
		Rishikim nr 6 Dt:15.01.2024
		Faqe 7 nga 6